



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	31.12.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-03-02-4674/15
PËR/ZA/TO:	z.Armend Vokshi, Drejtor i Administratës së Përgjithshme dhe Personelit në Komunën e Gjakovës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Vokshi,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (L.P.K.I), Agjencia “bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë të eprorëve të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”, (neni 19 paragrafi 1.5 i Ligjit nr.04/L-051). Agjencia kundër Korrupsionit duke u përgjigjur në kërkesën tuaj ku është thënë se:(në një Konkurs në Drejtorin e Arsimit në Komunën e Gjakovës ka aplikuar vajza e udhëheqësit të sektorit të arsimit e cila ka dalë me pikë më të larta dhe është përzgjedhur nga komisioni vlerësues i rekrutimit.

Udhëheqësi i sektorit nuk është deklaruar në fillim me shkrim që mund të jetë në konflikt të interesit dhe të tërhiqet nga pozita e tij e cila lidhet me çdo konkurs që hapet në Drejtorin e Arsimit. Me qen se ligji në fuqi nuk po e precizon saktë nëse është konflikt i interesit po ju drejtohem Agjencisë për një përgjigje profesionale si të veprohet pasi që e kemi pezulluar vendimin e komisionit).

Agjencia Kundër Korrupsionit duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë fushën përkatëse ofron këtë :

OPINION

Si institucion i pavarur Agjencia kundër Korrupsionit të cilës me ligj i janë besuar përgjegjësi të veçanta është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara me ligj.

Rrjedhimisht, çështja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është e rregulluar me Ligjin Nr. 04/L-051, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ky ligj në nenin 6 ka parapar nocionin e konfliktit të interesit ku thotë se Konflikti I interesit është gjendja e mospajtitimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik.

Po ashtu ky ligj ka kategorizuar zyrtarët e lartë të cilët janë të obliguar që të respektojnë rregullat dhe parimet që rrjedhin nga ky ligj.

Udhëheqësi i Sektorit të Arsimit në Drejtorin e Arsimit në Komunën tuaj për të cilin keni pyetur se a është konflikt i interesit nëse nuk është deklaruar me shkrim në konkursin ku ka aplikuar vajza e tij nuk hyn në listën zyrtareve të lart sipas Ligjit Nr. 04/L-051, mirëpo funksioni i ti hyn në kategorinë e shërbyesve civil të cilët kanë për obligim zbatimin e legjislacionit për Shërbimin Civil si dhe të gjitha rregulloret dhe aktet tjera të cilat kanë paraparë çështjen e parandalimit apo shmangies së konfliktit të interesit në shërbimin civil.

Duhet theksuar se është obligim i çdo zyrtari që të respektoj të gjitha ligjet në fuqi, andaj është obligim i zyrtareve që të respektojnë dhe të zbatojnë ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në të cilin ndër të tjera përcaktohen detyrimet e nëpunësve civil.

Në bazë të nenit 5 (paragrafi 8) të këtij ligji parashihet se nëpunësit civilë duhet të mos lejojnë që interesat e tyre private të bien ndesh me pozitën e tyre publike, të shmangin kryerjen e detyrave private ose publike, që bien ndesh me pozitën e tyre dhe që mund të krijojnë konflikt të interesit, ndërsa Rregullorja (QRK) Nr. 04/2015 për Kodin e Mirsjelljes në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në nenin 14 ka parapar Parandalimin e Konfliktit të Interesit (14.1) :



1. Nëpunësi civil gjatë ushtrimit të detyrave dhe përgjegjësi të tij duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vë para interesit publik.
2. Nëpunësi civil ushtron funksionin e tij në pajtim me Ligjin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit duke përfshirë por mos u kufizuar në Kodin përkatës Penal të Republikës së Kosovës, Ligjin përkatës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe në Ligjin përkatës për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
3. Nëpunësi civil gjatë kryerjes së detyrës kur ka dijeni për ekzistimin e konfliktit të interesit është i detyruar që: 3.1. të identifikoj nëse ka një konflikt të mundshëm të interesit; 3.2. të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur vet konfliktin e interesit.
4. Në rast se nëpunësi civil është në dyshim për ekzistimin apo jo të një konflikti të interesit lidhur me të ai duhet ta njoftoj dhe të këshillohet sa më parë me udhëheqësin e drejtpërdrejtë apo organin udhëheqës.
5. Çdo udhëheqës dhe organ udhëheqës në shërbimin civil duhet të marr të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur çfarëdo rasti të konfliktit të interesit.

Ndërsa neni 15 i kësaj rregullorje e ka parapa shmangien e konfliktit të interesit për shërbyesit civil.

1. Udhëheqësi i drejtpërdrejtë në bazë të të dhënave që disponon, duhet të ndërmerr masat e nevojshme që të shmangët emërimi ose zgjedhja e një personi në pozicione në të cilat mund të lindë ose ka konflikt të interesit.
2. Nëpunësi civil nuk mund të ngarkohet me detyra që mund të çojnë në lindjen e konfliktit të interesit.
3. Nëpunësi civil i cili ka interesa që vazhdimësia e zotërimit të tyre do të përbënte rrezik real për lindjen e konfliktit të interesit dhe do të sillte përjashtimin e vazhdueshëm nga veprimtaria e tij zyrtare ose pamundësinë për të ushtruar detyrat zyrtare, duhet të heqë dorë ose t'i transferoj këto interesa në mënyrë që të shmangë konfliktin e interesit.

Prandaj duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë më lartë, ju rekomandojmë që të veproni konform ketyre disopozitave dhe parimeve të bazuar në Ligjet dhe rregulloret në fuqi për të parandaluar dhe shmangur çdo situatë që mund të sjellë gjendje të konflikti të interesit.

Me respekt!